INSTITUTI
DEMOKRATIK
I KOSOVËS

# DIALOGU KOSOVË-SERBI

## GJATË SESIONIT PRANVEROR TË LEGJISLATURËS SË GJASHTË TË KUVENDIT TË KOSOVËS (Janar – Gusht 2019)

Janar, 2020



INSTITUTI
DEMOKRATIK
I KOSOVËS

# DIALOGU KOSOVË-SERBI

## GJATË SESIONIT PRANVEROR TË LEGJISLATURËS SË GJASHTË TË KUVENDIT TË KOSOVËS (Janar – Gusht 2019)

**Janar, 2020**

E drejta e autorit © 2020. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,
10 000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +383 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Ueb: www.kdi-kosova.org

Layout and design: **envinion**

**Vërejtje:** Ky raport është rezultat i një hulumtimi që është realizuar në kuadër të projektit *"Perspektiva Evropiane – ndërtimi i konsensusit kombëtar për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë"*, i financuar nga Ambasada Zvicerane në Prishtinë.

Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), dhe në asnjë rrethanë nuk do të konsiderohet që reflekton qëndrimet e Ambasadës Zvicerane në Prishtinë.

# TABELA E PËRMBAJTJES


**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE ..... 7**

**HYRJE ..... 9**

**1. DIALOGU NË NUMRA: SEANCAT PLENARE DHE KOMISIONET PARLAMENTARE ..... 10**

**2. MBIKËQYRJA PARLAMENTARE NDAJ DIALOGUT KOSOVË – SERBI ..... 11**

2.1 Pyetjet Parlamentare ..... 11

2.2 Debatet Parlamentare ..... 12

**3. TEMAT KYÇE ..... 13**

3.1. Ideja e korrigjimit të kufijve ..... 13

3.2. Miratimi i Ligjit për Delegacionin Shtetëror dhe Platformës për Dialogun ..... 14

3.2.1. Transparenca dhe Llogaridhënia e Delegacionit Shtetëror ndaj Kuvendit ..... 15

3.3 Iniciativat e Kuvendit lidhur me ndëshkimin e krimeve të luftës të kryera në Kosovë ..... 16

**4. DIALOGU KOSOVË-SERBI NË KOMISIONE PARLAMENTARE ..... 17**

4.1. Raportimet e Ekzekutivit në Komisione ..... 17

4.2 Vizitat në terren të Komisioneve për monitorimin e zbatimit të marrëveshjeve të Dialogut ..... 18

4.3 Çështjet tjera rreth dialogut të diskutuara në Komisionet Parlamentare ..... 20

4.3.1 Komisioni për Buxhet dhe Financa ..... 20

4.3.2 Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim ..... 20

4.3.3 Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit ..... 21

4.3.4 Komisioni për Integrime Evropiane ..... 21

4.3.5 Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike ..... 22

4.3.6 Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal ..... 22

4.3.7 Diskutimet rreth dialogut në Komsione tjera ..... 23

**5. PËRFUNDIM DHE REKOMANDIME ..... 24**

**6. ANEKS ..... 26**

# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Çështja e dialogut Kosovë - Serbi ishte temë përplasjesh në mes të deputetëve të Kuvendit edhe gjatë sesionit pranveror (janar – gusht) të vitit 2019. Ky ishte sesioni i fundit i legjislaturës së VI-të, meqë më 22 gusht 2019 Kuvendi i Kosovës u shpërnda, pas dorëheqjes së Kryeministrit të vendit z. Ramush Haradinaj.

Si përgjigje ndaj idesë së korrigjimit të kufijve të mbështetur nga Presidenti Thaçi, edhe gjatë këtij sesioni vazhduan përpjekjet e një pjesë të opozitës dhe Qeverisë për të krijuar një delegacion shtetëror për përfaqësimin e Kosovës në dialog me Serbinë. Kjo fillimisht u bë me vendim të Qeverisë më 3 shtator 2018, e më pas edhe përmes rezolutës për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, të iniciuar nga grupi parlamentar i PSD-së.[1] Kjo rezolutë u votua në Kuvend më 15 dhjetor 2018, nga partitë e koalicionit qeverisës (përjashtuar Listën Serbe) dhe partisë opozitare PSD, me 59 vota "për" dhe dy abstenime. Ndërsa partitë më të mëdha opozitare, LDK dhe LVV e bojkotuan seancën dhe e cilësuan këtë nismë si jo legjitime.

Gjithsesi, Rezoluta e 15 dhjetorit i kërkoi delegacionit shtetëror nxjerrjen e dy dokumenteve përkatësisht Ligjit për Delegacionin Shtetëror dhe Platformën për Dialogun, brenda një muaji. Pavarësisht afatit të përcaktuar me Rezolutë, këto dy dokumente nuk u votuan deri më 7 mars 2019, me votat e koalicionit qeverisës (sërish pa votat e Listës Serbe) dhe subjektit opozitar PSD. Ligji u votua me 59 vota "për" dhe 3 abstenime ndërsa, Platforma u votua me 61 vota "për" dhe një abstenim. Dy partitë më të mëdha opozitare, LDK dhe LVV kontestuan Ligjin për Delegacionin në Gjykatën Kushtetuese, e cila më 27 qershor 2019 këtë ligj e shpalli në tërësinë e tij të papajtueshëm me Kushtetutën. Ky aktgjykim ndikoi dhe në vlefshmërinë juridike të Platformës për Dialogun e miratuar në Kuvend.

Çështja e dialogut Kosovë - Serbi ishte temë përplasjesh në mes të deputetëve të **Kuvendit edhe gjatë sesionit pranveror (janar – gusht) të vitit 2019.**

Që nga themelimi i Delegacionit Shtetëror në dhjetor të vitit 2018 dhe deri në momentin e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, pavarësisht zotimeve dhe kërkesave të Rezolutës, mungesa e transparencës në punën e Delegacionit ishte po aq e theksuar dhe e pranishme, si që nga fillimi i vetë procesit të dialogut. Delegacioni nuk raportoi asnjëherë në Kuvend lidhur me aktivitetet e tyre, nuk bëri të ditur procedurat mbi të cilat punësoi stafin mbështetës, si dhe nuk bëri të ditura shpenzimet financiare.

Gjatë sesionit pranveror, polarizimi politik mbi të ardhmen e procesit të dialogut, u shpërfaq edhe me mos arritjen e dakordimit për miratimin e një rezolute në Kuvend të propozuar nga LDK, LVV dhe Alternativa, e cila përmbante 1 pikë të vetme ku thuhej se: *"territori i Republikës së Kosovës është një dhe i pa ndashëm dhe se as Presidenti, e askush tjetër, nuk ka mandat të negociojë për territorin e Republikës së Kosovës".*[2] Partitë në

1 Shih Rezolutën për Normalizimin e Marrëdhënieve me Serbinë të miratuar nga Kuvendi me 15 dhjetor 2018 në, http://kuvendi6.votaime.org/Uploads/Data/Documents/2018_12_18_Rezoluta06-R-015_USUNuUR6vm.pdf

2 Shih Rezolutën e propozuar nga LDK, LVV dhe Alternativa në, https://gazetablic.com/publikohet-rezoluta-e-plote-e-ldk-se-qe-pritet-te-votohet-sot-ne-kuvend/

pushtet propozuan një tjetër Rezolutë, ku deklaruan se çështja e territorit të Kosovës do të adresohej, por që do të përmbante dhe elemente të tjera rreth procesit të dialogut. Rezoluta e propozuar nga PSD dhe e mbështetur nga partitë në pushtet u votua më 15 dhjetor nga këto parti. Ndërsa Rezoluta e propozuar nga LVV dhe LDK ishte pikë e rendit të ditës në gjashtë seanca gjatë sesionit pranveror dhe përfundoi pa iu nënshtruar procesit të votimit në mungesë kuorumi.

Një tjetër çështje që ndikoi në procesin e dialogut Kosovë-Serbi ishte dhe taksa prej 100% e vendosur nga ana e Qeverisë së Kosovës ndaj produkteve të importuara nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina në nëntor 2018. Meqë, Serbia kushtëzoi rikthimin e saj në tryezën e diskutimit me tërheqjen e kësaj mase. Pavarësisht qëndrimeve të ndryshme të artikuluara edhe nga anëtarët e koalicionit qeverisës rreth kësaj mase tarifore, si pasojë e presionit ndërkombëtar që kërkoi pezullimin e të njëjtës, Qeveria e Kosovës nuk e tërhoqi taksën. Si rrjedhojë, gjatë gjithë sesionit pranveror dialogu Kosovë-Serbi ishte i pezulluar.

Pavarësisht pezullimit, çështja e dialogut u diskutua në 73% të të gjitha seancave plenare në sesionin pranveror 2019, në 47% prej të cilave ishte pikë e rendit të ditës. Megjithatë deputetët e Kuvendit nuk shfrytëzuan mjaftueshëm mekanizmat mbikëqyrës në dispozicion për të kërkuar transparencë dhe llogaridhënie të ekzekutivit sa i përket çështjes së dialogut. Tema e korrigjimit të kufijve, Ligji për Delegacionin dhe Platforma për Dialogun mbizotëruan diskutimet rreth dialogut në Kuvend gjatë sesionit pranveror deri në shpërbërjen e Legjislaturës së gjashtë në gusht 2019.

Deputetët parashtruan vetëm shtatë pyetje parlamentare rreth dialogut nga 94 pyetje të përgjithshme. U shënua një rënie në numirn e pyetjeve krahasuar me sesionin e njëjtë të vitit 2018, ku ishin parashtruar gjithsej nëntë pyetje rreth kësaj çështje. Kabineti qeveritar u përgjigj në vetëm katër nga shtatë pyetjet e parashtruara rreth dialogut nga ana e deputetëve të Kuvendit gjatë këtij sesioni, duke e bërë këtë mekanizëm mbikqyrës në dispozicion të deputetëve të mbetet ende pak i përdorur. Në anën tjetër, deputetët e Kuvendit inicuan vetëm një debat parlamentar dhe katër raportime të ministrave. Në anën tjetër nuk pati ndonjë interpelancë ndaj ekzekutivit për këtë çështje. Përveç kësaj, deputetët e Kuvendit ndërmorën iniciativa me anë të së cilave synuan adresimin e krimeve të kryera në Kosovë gjatë luftës së fundit nga ana e shtetit serb. Në kuadër të kësaj, Kuvendi miratoi një rezolutë për gjenocidin serb[3] për të cilën paraprakisht themeloi një Komision Ad hoc, i cili kishte për mandat hartimin e kësaj rezolute. Ndërsa nismat e tjera të propozuara lidhur me këtë temë si, krijimi i Tribunalit për gjenocidin serb në Kosovë nuk arritën të formalizoheshin përtej deklaratave të bëra.

Duke konsideruar që fokusi primar në diskursin publik dhe politik ishte e ardhmja e procesit dhe përpjekjet për arritjen e një marrëveshjeje ligjërisht të obligueshme, ndërsa vet procesi i dialogut ishte i pezulluar, kjo bëri që statusi i marrëveshjeve të arritura të ishte i paqartë gjatë kësaj periudhe kohore. Për më tepër, nuk kishte takime as teknike në mes palëve nën ndërmjetësimin e BE-së për zbatimin e këtyre marrëveshjeve. Këto dy elemente ndikuan dhe në punën e komisioneve parlamentare. Rrjedhimisht, komisionet parlamentare ishin më pak aktive në trajtimin e çështjeve të ndërlidhura me dialogun Kosovë-Serbi. Këto tema përbënë vetëm 13% të diskutimeve në mbledhjet e komisioneve parlamentare. Ndërsa, në kuadër të aktiviteteve mbikëqyrëse, komisionet gjatë këtij sesioni organizuan dy vizita në terren, me qëllim të informimit të anëtarëve të komisionve përkatëse për çështje të ndërlidhura me dialogun. Konkretisht, Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal me mbështetje të Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), realizoi një vizitë në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP). Kurse, Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi, si dhe Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media realizuan një vizitë të përbashkët në terren në Luginën e Preshevës.

3 Shih Rezolutën për Gjenocidin Serb të kryer në Kosovë në, http://kuvendi6.votaime.org/Uploads/Data/Documents/2019_05_22_Rezolutenr.017perg-jenocidinekryerserbneKosove,dt.16.05.2019_hg4F3BvJFu.pdf

# HYRJE

Ky raport nxjerr në pah punën e Kuvendit të Kosovës në kapacitetin e tij mbikëqyrës ndaj ekzekutivit të vendit rreth procesit të dialogut Kosovë - Serbi gjatë sesionit pranveror (janar – gusht 2019).

Në pjesën e parë të raportit ofrohet një përmbledhje e përgjithshme e çështjeve lidhur me procesin e dialogut Kosovë – Serbi që kanë mbizotëruar në seanca dhe komisione parlamentare, përkatësisht temat më të diskutuara dhe iniciativat kryesore të ndërmarra nga Kuvendi, gjatë sesionit pranveror rreth kësaj çështje.

Në pjesën e dytë të raportit është paraqitur një pasqyrë me e detajuar e aktiviteteve mbikëqyrëse të deputetëve të Kuvendit në seanca ndërmjet mekanzimave si, pyetjet parlamentare, debatet parlamentare të deputetëve ndaj ekzekutivit, raportimet e ministrave në komisione dhe vizitat në terren të komisioneve, për të monitoruar nga afër gjendjen e zbatimit të marrëveshjeve të dialogut.

Në pjesën e tretë të raportit, ofrohet një analizë e temave më specifike të trajtuara në Kuvend, si ajo e 'korrigjimit të kufijve', Ligji për delegacionin shtetëror dhe platformën për dialogun, transparenca dhe llogaridhënia e delegacionit shtetëror ndaj Kuvendit dhe iniciativat e ndërmarra nga Kuvendi për adresimin e krimeve të luftës të kryera në Kosovë nga ana e Serbisë.

Në pjesën e katërt të raportit trajtohet dialogu në komisionet parlamentare, sa kanë qenë aktive komisionet parlamentare në mbikqyrjen e këtij procesi, sa herë kanë raportuar ministrat e Ekzekutivit në komisione lidhur me këtë çështje, cilat tema kanë mbizotëruar në komisione parlamentare, vizitat në terren të organizuara dhe komisionet që kanë trajtuar më së shumti këtë çështje.

Në pjesën e fundit të raportit, KDI ka ofruar edhe rekomandimet për legjislaturën e re, e cila ka dalë nga zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit 2019, me qëllim të fuqizimit të rolit mbikëqyrës të Kuvendit ndaj procesit të dialogut Kosovë - Serbi.

Në aneks të këtij raporti janë të paraqitura të gjitha aktivitetet e deputetëve në seanca dhe komisione parlamentare lidhur me çështjen e dialogut me Serbinë.

# 1. DIALOGU NË NUMRA: SEANCAT PLENARE DHE KOMISIONET PARLAMENTARE

Gjatë sesionit pranveror të vitit 2019, çështjet e ndërlidhura me dialogun Kosovë - Serbi ishin më shumë pjesë e diskutimeve në seanca të Kuvendit, e më pak në mbledhjet e komisioneve parlamentare.[4] Kjo temë ishte 22 herë pikë e rendit të ditës në afro gjysmën e seancave, përkatësisht në 14 prej 30 seancave të mbajtura, ndërsa në përgjithësi tema e dialogut u diskutua në 73% të seancave plenare. Temat më të diskutuara gjatë seancave ishin, ideja e korrigjimit të kufijve/shkëmbimit të territoreve, Ligji 06/L-145 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë, Platforma për Dialogun mbi Marrëveshjen përfundimtare gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë, taksa 100% ndaj produkteve të Serbisë dhe BeH, reciprociteti ndaj Serbisë, si dhe dënimi i gjenocidit serb të kryer në Kosovë.

Në anën tjetër, në mbledhjet e komsioneve çështja e dialogut ishte 20 herë pikë e rendit të ditës në 18 mbledhje të komisioneve parlamentare, prej gjithsej 226 mbledhjeve të mbajtura. Në 11 mbledhje tjera, u diskutua jashtë rendit të ditës, ose në kuadër të pikave tjera të rendit të ditës.

Tri nga komisionet parlamentare respektivisht Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike,

> Kjo temë ishte 22 herë pikë e rendit të ditës në afro gjysmën e seancave, përkatësisht në 14 prej 30 seancave të mbajtura, **ndërsa në përgjithësi tema e dialogut u diskutua në 73% të seancave plenare.**

Komisioni për Integrime Evropiane dhe Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, kanë përfshirë mbikëqyrjen e procesit të dialogut edhe në planet e tyre të punës për vitin 2019.

Temat më të diskutuara lidhur me dialogun në mbledhjet e komisioneve ishin, Ligji për Delegacionin Shtetëror, taksa 100%, pengesat e Serbisë në subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës, marrëveshja për telekomunikacionin dhe personat e pagjetur.

4 Shih kalendarin e takimeve dhe seancave në ueb faqën zyrtare të Kuvendit të Kosovës në, http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,159&date=2019-06-19 dhe platformën online të KDI-së Vota Ime në, http://www.votaime.org/Public/PlenarySessions

# 2. MBIKËQYRJA PARLAMENTARE NDAJ DIALOGUT KOSOVË – SERBI

Deputetët e Kuvendit ushtrojnë rolin e tyre mbikëqyrës ndaj ekzekutivit edhe përmes mekanizmave siç janë, interpelancat, pyetjet parlamentare dhe debatet parlamentare. Gjatë këtij sesioni deputetët parashtruan gjithsej 94 pyetje parlamentare, shtatë prej të cilave ishin për dialogun. Ndërsa, u mbajtën 12 debate parlamentare, prej të cilave vetëm një prej tyre ishte rreth dialogut. Gjatë kësaj periudhe u organizuan edhe dy interpelanca mirëpo, asnjëra prej tyre nuk ishte lidhur me çështjen e dialogut.

Deputetët e Kuvendit i parashtruan Kryeministrit dhe Ministrave shtatë pyetje parlamentare lidhur me dialogun, **7% nga numri i përgjithshëm prej 94 pyetjeve parlamentare të parashtruara gjatë këtij sesioni.**

## 2.1 Pyetjet Parlamentare

Gjatë sesionit pranveror janë parashtruar 94 pyetje parlamentare rreth çështjeve të ndryshme për kabinetin qeveritar, ku prej tyre vetëm 38 kanë marrë përgjigje. Krahasuar me sesionin e kaluar pranveror, ku u parashtruan gjithsej 238 pyetje parlamentare, këtë sesion Kuvendi i Kosovës ka pasur rënie të numrit të pyetjeve të parashturara. Për më tepër pati edhe rënie të numrit të pyetjeve rreth dialogut në krahasim me sesionin e njëjtë të vitit paraprak gjatë së cilit ishin parashtruar nëntë pyetje lidhur me këtë çështje. Gjithsesi, ky mekanizëm mbikqyrës nuk është përdorur sa duhet nga deputetët e Kuvendit për të adresuar çështjet rreth procesit të dialogut, nga ana tjetër Qeveria nuk ka qenë e gatshme për t'ju përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga deputetët, ku rreth 40% e tyre mbeten pa përgjigje.

Deputetët e Kuvendit i parashtruan Kryeministrit dhe Ministrave shtatë pyetje parlamentare lidhur me dialogun, 7% nga numri i përgjithshëm prej 94 pyetjeve parlamentare të parashtruara gjatë këtij sesioni. Katër pyetje u parashtruan nga deputetët e LVV-së, dy pyetje nga deputetët e LDK-së dhe një pyetje nga një deputet i PDK-së. Përfaqësuesit e Qeverisë u përgjigjën në katër prej pyetjeve të parashtruara nga deputetët, ndërsa në tri prej tyre nuk pati përgjigje. Për më tepër, vonesat në dhënien e përgjigjeve në pyetjet e parashtruara ka bërë që të humbet rëndësia e tyre dhe në disa raste deputetët kanë refuzuar të parashtrojnë pyetjet e tyre për shkak të mosprezencës së ministrave përkatës.

Çështja kryesore e ngritur në këto pyetje ishte prezenca e produkteve nga Serbia dhe BeH në tregun e Kosovës, përkundër vendosjes së taksës prej 100% ndaj këtyre shteteve. Deputetët po ashtu kërkuan që të informohen nga

ekzekutivi lidhur me masat e ndërmarra nga kjo e fundit për forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës dhe anëtarësimin në organizata ndërkombëtare.

## 2.2 Debatet Parlamentare

Gjatë këtij sesioni në Kuvendin e Kosovës është mbajtur vetëm një debat parlamentar lidhur me dialogun Kosovë - Serbi. Ai ishte propozuar më 19 nëntor 2018[5] me kërkesë të deputetit Korab Sejdiu dhe 12 deputetëve nënshkrues nga subjektet opozitare, lidhur me nevojën urgjente për vendosje të sanksioneve ekonomike (përfshirë embargon) dhe sanksioneve politike kundër Serbisë, si masë reciprociteti. Ky debat nuk ishte mbajtur gjatë vitit 2018 dhe në sesionin pranveror të vitit 2019 ishte pikë e rendit të ditës qysh në seancën e parë. Megjithatë, në konsultim me propozuesin ky debat ishte shtyrë për seanca tjera, ndërsa u mbajt 4 muaj pas, më konkretisht në seancën e 12 prillit. Disa ditë para kërkesës për këtë debat Qeveria e Kosovës, veçse kishte marrë vendim më 6 nëntor, për vendosjen e masave mbrojtëse prej 10% në produktet e importuara nga Serbia dhe BeH.[6] Ndërsa, në ndërkohë me 21 nëntor, ajo kishte rritur këto masa në 100% ndaj produkteve të këtyre dy shteteve.[7]

Gjatë këtij diskutimi deputeti Sejdiu, kishte propozuar që së bashku me përfaqësuesit e grupeve parlamentare të hartohej një rezolutë lidhur me këtë çështje, e cila do të votohej në Kuvend. Qëllimi i kësaj rezolute ishte që Qeveria të detyrohej që reciprocitetin ta përdorte, ndër të tjera, si masë për disiplinimin e sjelljeve të Serbisë karshi Kosovës, si dhe si vegël për përmirësimin e pozitës negociuese të Kosovës në dialogun me Serbinë. Po ashtu, pjesë e kësaj rezolute të ishte edhe detyrimi

> Gjatë këtij sesioni në Kuvendin e Kosovës është mbajtur vetëm **një debat parlamentar lidhur me dialogun Kosovë - Serbi.**

për bashkëpunim të ngushtë me miqtë ndërkombëtar, me qëllim që zbatimi i reciprocitetit të kishte mbështetje të plotë si brenda ashtu edhe nga jashtë.

Ky propozim ishte përkrahur nga grupi parlamentar i LDK-së, LVV-së, PSD-së dhe NISMA-s, ndërsa ishte kritikuar si iniciativë jo serioze dhe e tejkaluar nga grupi parlamentar i PDK-së, me arsyetimin se Qeveria veçse kishte ndërmarrë masa ndaj Serbisë me vendosjen e taksës fillimisht prej 10% dhe me pas 100%, para gjashtë muajsh. Edhe përfaqësuesit e grupit parlamentar të AAK-së kishin ndarë mendimin me këtë të fundit dhe kishin kërkuar nga të gjitha grupet parlamentare që të mbështesin Kryeministrin Haradinaj në mbajtjen e taksës 100% ndaj Serbisë dhe BeH. Ky debat u karakterizua me përplasje mes deputetëve nga koalicioni qeverisës dhe subjektet opozitare.[8] Në fund të debatit propozuesi u bëri thirrje grupeve parlamentare që të hartonin bashkarisht një rezolutë dhe ta sillnin atë në Kuvend për votim, të cilën pastaj Qeveria mund ta shfrytëzonte si udhërrëfyes. Mirëpo, një propozim rezolutë për këtë çështje nuk u soll në seancat e radhës të këtij sesioni dhe ky debat përfundoi pa ndonjë qëndrim konkret nga ana e Kuvendit lidhur me çështjen e reciprocitetit ndaj Serbisë.

5 Shih transkriptin e seancës së mbajtur me 12 prill 2019 në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_s_2019_04_12_10_7963_al.pdf

6 Shih vendimin e Qeverisë së Kosovës të datës 6 nëntor 2018, për vendosjen e masave mbrojtëse prej 10% ndaj Serbisë dhe BeH në, http://kryeministri-ks.net/ëp-content/uploads/2018/11/IMG_2387.jpg

7 Shih vendimin e Qeverisë së Kosovës të datës 21 nëntor 2018, për vendosjen e masave mbrojtëse prej 100% ndaj Serbisë dhe BeH në, http://kryeministri-ks.net/ëp-content/uploads/2018/11/Lista-e-mallrave-te-perjashtuara.pdf

8 Shih transkriptin e seancës së mbajtur me 12 prill 2019 në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_s_2019_04_12_10_7963_al.pdf

# 3. TEMAT KYÇE

## 3.1. Ideja e korrigjimit të kufijve

Gjatë sesionit pranveror në seancat e Kuvendit, disa nga temat e diskutimit ishin bartur edhe nga viti 2018. Disa prej tyre ishin Ligji për Delegacionin Shtetëror, Platforma për Dialogun, taksa 100% ndaj produkteve të Serbisë dhe BeH, dhe idea e 'korrigjimit të kufijve'. Me këtë të fundit deputetët e filluan edhe këtë sesion, ku në seancën e parë pikë e rendit të ditës ishte votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e "shkëmbimit të territoreve" apo "korrigjimit të kufijve" në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Kjo rezolutë ishte propozuar nga tri subjektet opozitare LDK, LVV dhe Alternativa dhe kishte qenë pikë e rendit të ditës që nga shtatori i vitit 2018. Pavarësisht diskursit të vazhdueshëm brenda dhe jashtë Kuvendit, nga të gjitha partitë politike se ideja e korrigjimit të kufijve ishte e rrezikshme dhe e papranueshme për Republikën e Kosovës[9], spektri politik nuk arritën dakordim për kalimin e një rezolute që ndalonte vazhdimin e saj. Partitë në pushtet përkatësisht PDK, AAK dhe Nisma në tetor të vitit 2018 kishin propozuar që të votohej një Rezolutë gjashtë pikëshe, e cila parashihte mbështetjen e dialogut nga ana e Kuvendit, arritjen e konsensusit të gjerë politik, themelimin e një komisioni të veçantë me përgjegjësi për ta monitoruar procesin e dialogut, raportimin e delegacionit në këtë komision, rolin qendror të Kuvendit në procesin e dialogut, moscenimin e sovranitetit shtetëror, integritetit territorial dhe karakterit unitar të Republikës së Kosovës si dhe përcaktimin e Kuvendit si autoriteti i vetëm për të vendosur lidhur me çështjen e korrigjimit dhe çështjen e unitetit.[10]

Pavarësisht diskursit të vazhdueshëm brenda dhe jashtë Kuvendit, nga të gjitha partitë politike se ideja e korrigjimit të kufijve ishte e rrezikshme dhe e papranueshme për Republikën e Kosovës , **spektri politik nuk arritën dakordim për kalimin e një rezolute që ndalonte vazhdimin e saj.**

LDK dhe LVV kishin refuzuar votimin e të njëjtës, pasi kërkonin zgjedhje të parakohshme dhe legjimitet të qeverisë para vazhdimit të dialogut. Këto dy subjekte vazhduan kundërshtimet për themelimin e Delegacionit Shtetëror edhe në sesionin pranveror kur u bë shqyrtimi i Ligjit për Delegacionin dhe Platformës për Dialogun. Ato kërkonin që vendi të shkonte në zgjedhje para çdo hapi lidhur me dialogun, në mënyrë që udhëheqja e këtij procesi të legjitimohej përmes votës së qytetarëve.[11]

9 Shih transkriptin e seancës së 31 tetor dhe 1 nëntor 2018 në, http://www.votaime.org/Uploads/Data/Documents/trans__2018_10_31_10_7679_al_ATx-NvavEë3.pdf

10 Shih transkriptin e seancës së 31 tetorit 2018, fq.11, në http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans__2018_10_31_10_7679_al.pdf

11 "Zgjedhjet para dialogut, thonë LDK e VV", 30 dhjetor 2018, http://www.veriu.info/zgjedhjet-para-dialogut-thone-ldk-e-vv/

Si rezultat i mungesës së konsensusit, Rezoluta e propozuar nga LDK, LVV dhe Alternativa ishte pikë e rendit të ditës në gjashtë seanca gjatë sesionit pranveror, megjithatë ajo nuk u hodh asnjëherë në votim si rezultat i mungesës së kuorumit. Herën e fundit kur kjo çështje ishte pikë e rendit të ditës, në seancën e 19 qershorit, për këtë propozim - rezolutë votuan vetëm 28 deputetë dhe ajo u shtye për mbledhje tjera.[12] Kështu, sesioni pranveror rrjedhimisht edhe kjo legjislaturë, përfundoi pa miratim të rezolutës së dy partive opozitare, ndërsa partitë në pushtet argumentuan në vazhdimësi që çështjen e korrigjimit të kufijve e kishin trajtuar me Rezolutën e re të kaluar në Kuvend më 15 dhjetor 2018 dhe me Platformën për dialogun Kosovë-Serbi.

Pavarësisht përpjekjeve që këto dokumente të gjenin mbështetje të gjerë politike, grupet parlamentare të LDK-së dhe LVV-së **kontestuan legjimitetin e tyre dhe sfiduan Ligjin për Delegacionin në Gjykatën Kushtetuese.**

## 3.2. Miratimi i Ligjit për Delegacionin Shtetëror dhe Platformës për Dialogun

SRezoluta mbi procesin e Dialogut për Normalizimin e Marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, e miratuar më 15 dhjetor të vitit 2018[13], obligonte palët për propozimin e Ligjit dhe Platformës në afat një mujor, afat ky i cili nuk u respektua.[14] Gjithashtu rezoluta, ndër të tjera parashihte, që Kuvendi do të angazhohej për arritjen e një konsensusi sa më të gjerë ndërmjet përfaqësuesve politikë, shoqërisë civile dhe qytetarëve të vendit për procesin e dialogut. Procesi i arritjes së këtij konsensusi do të zhvillohej nëpërmjet hartimit të Platformës së Dialogut, dokument i cili do të përcaktonte parimet themelore dhe pozicionin shtetërorë mbi të cilin do të zhvillohej dialogu Kosovë - Serbi.

Kjo rezolutë po ashtu parashihte që Kuvendi i Kosovës do të votonte edhe Ligjin për Dialogun me të cilin do të sigurohej vlefshmëria juridike dhe sanksionimi ligjor i përmbajtjes së Platformës dhe të përgjegjësive të përfaqësuesve të Delegacionit Shtetëror.

Më 7 mars të vitit 2019, Kuvendi miratoi Ligjin për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e Dialogut me Republikën e Serbisë si dhe Platformën për Dialogun mbi Marrëveshjen përfundimtare gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë. Ashtu si Rezoluta mbi procesin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve edhe këto dy dokumente u miratuan me votat e deputetëve të PSD-së dhe grupeve parlamentare të koalicionit qeverisës (me përjashtim të atyre të Listës Serbe). Pavarësisht përpjekjeve që këto dokumente të gjenin mbështetje të gjerë politike, grupet parlamentare të LDK-së dhe LVV-së kontestuan legjimitetin e tyre dhe sfiduan Ligjin për Delegacionin në Gjykatën Kushtetuese.

12 Shih transkriptin e vazhdimit të mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e mbajtur më 19 qershor 2019, fq. 19, në http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_s_2019_06_19_10_8102_al.pdf (qasur më 21 gusht 2019)

13 Kjo rezolutë ishte miratuar nga Kuvendi me 59 vota 'për' dhe dy abstenime. Pro saj kishin votuar deputetët e PSD-së dhe grupet parlamentare të koalicionit qeverisës, me përjashtim të grupit parlamentar të Listës Serbe (LS). Ndërsa, dy partitë opozitare LDK dhe LVV nuk kishin marrë pjesë fare në seancë

14 Shih tekstin e rezolutës të propozuar nga PSD në, http://www.votaime.org/Uploads/Data/Documents/2018_12_18_Rezoluta06-R-015_USUNuUR6vm.pdf

Më 27 qershor, Gjykata Kushtetuese publikoi aktgjykimin e saj me anë të së cilit shpalli ligjin si kundër kushtetues, për arsye se nenet thelbesore të Ligjit nuk ishin në pajtueshmëri me Kushtetutën.[15] Me këtë vendim Gjykata Kushtetuese rikonfirmoi që punët e jashtme ishin obligim i Kryeministrit, në konsultim me Presidentin, duke përmbyllur kështu diskutimin e gjatë se kush duhet të udhëhiqte me procesin e dialogut.

Pas vendimit të Gjykatës statusi juridik i Platformës për Dialogun mbeti i paqartë,[16] pasi që Rezoluta përcaktonte vlefshmërinë juridike të këtij dokumenti vetëm përmes Ligjit. Vlen të theksohet, se KDI kishte analizuar Ligjin për Delegacionin para se i njëjti të votohej në Kuvend, duke informuar deputetët se disa dispozita të Ligjit nuk ishin në pajtueshmëri me Kushtetutën.

Një ditë pas publikimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, deputetët e Kuvendit nga partitë në pushtet dhe në opozitë diskutuan shkurtimisht rreth këtij vendimi, në kuadër të një seance të jashtëzakonshme rreth heqjes së monopolit lidhur me shërbimin e homologimit të veturave. Ata shprehën mbështetje e tyre për vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

### 3.2.1. Transparenca dhe Llogaridhënia e Delegacionit Shtetëror ndaj Kuvendit

Qeveria e Kosovës me vendim ndau buxhetin prej 300 mijë Euro për shpenzimet rreth administratës së Delegacionit[17] – themelimi i të cilit ishte paraparë në Rezolutën e 15 dhjetorit. Menjëherë ky delegacion filloi takimet me akterë vendor dhe ndërkombëtar duke deklaruar se tashmë ky mekanizëm do të udhëhiqte me procesin e dialogut. Delegacioni pati takime dhe në Bruksel me kabinetin e Përfaqësueses së BE-së Federica Mogherinit. Deklaratat publike të delegacionit theksuan përkushtimin e tyre për transparencë si dhe deklaruan se tashmë dialogu i ishte rikthyer Kuvendit.

Për periudhën sa vepruan, përfaqësuesit e Delegacionit Shtetëror vazhduan praktikën e mungesës së transparencës dhe llogaridhënies, **fenomen ky që ka shoqëruar pothuajse gjithë procesin e dialogut Kosovë - Serbi që nga fillimi i tij në vitin 2011.**

Për periudhën sa vepruan, përfaqësuesit e Delgacionit Shtetëror vazhduan praktikën e mungesës së transparencës dhe llogaridhënies, fenomen ky që ka shoqëruar pothuajse gjithë procesin e dialogut Kosovë - Serbi që nga fillimi i tij në vitin 2011. Përfaqësuesit e Delegacionit nuk raportuan asnjëherë në Kuvendin e Kosovës mbi aktivitetet që kishin zhvilluar që nga themelimi i tyre. Në anën tjetër, deputetët e Kuvendit nuk ftuan në raportim asnjëherë këtë Delegacion meqë dy nga partitë opozitare konstestuan legjimitimetin dhe legalitetin e tij, ndërsa partitë e tjera që votuan për

15 Shih Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në rastin nr. K043/19, parashtrues: Albulena Haxhiu, Driton Selmanaj dhe tridhjetë deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vleresim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. o6/L-145 për Detyrat, Përgjegjesitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë. Prishtinë, më 27 qershor 2019, Nr. ref.: 1387/19 në, http://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2019/06/ko_43_19_agj_shq.pdf

16 Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese KDI kishte organizuaur një konferencë për shtyp me 4 shtaor 2018, ku kishte nga Qeveria e Kosovës që të qartësonte vlefshmërinë e Platformës së propozuar nga Delegacioni Shtetëror, i cili ishte votuar në Kuvendin e Kosovës, nëse e njëjta do vazhdonte të mbetej si qëndrim zyrtar i Kosovës në këtë proces. Shih komunikatën e kësaj konference në, http://www.votaime.org/Public/DialogActivity/Detail/349

17 Vendimi i Qeverisë për ndarjen e mjeteve financiare për Delegacionin Shtetëror, http://www.votaime.org/Uploads/Data/Documents/VendimiiQeverisepernd arjenemjetevefinanciareperDelegacioninShteteror_24dhjetor2018_zq6cgJëFhN.pdf

formimin e këtij Delegacioni nuk ndërmorën ndonjë hap në këtë drejtim. Në këtë rast u dëshmua qartazi mungesa e ndarjes së funksioneve dhe përgjegjësive që deputetët e Kuvendit kanë në mbajtjen e qeverisë llogaridhënëse duke i shërbyer interesit partiak.

Gjatë periudhës dhjetor 2018 deri në qershor 2019, ky Delegacion realizoi një sërë takimesh brenda dhe jashtë vendit si dhe shpenzoi një pjesë të buxhetit për realizimin e udhëtimeve zyrtare. KDI me anë të një kërkese për qasje në dokumente zyrtare kërkoi informacione, të njëjtat iu dhanë me vonesë dhe jo të plota. Po ashtu, Delegacioni emëroi edhe personelin administrativ për mbështetje të Delegacionit, mirëpo procedurat e emërimit, funksionet dhe përgjegjësitë e tyre nuk u bën publike. Pavarësisht faktit që Delegacioni Shtetëror premtoi që me ta në krye të dialogut, do të kishte transparencë dhe llogaridhënie ndaj Kuvendit rreth procesit të dialogut, në realitet ky premtim nuk u përmbush. Argumenti i përdorur nga Delegacioni ishte mungesa e takimeve formale me Serbinë në Bruksel.

## 3.3 Iniciativat e Kuvendit lidhur me ndëshkimin e krimeve të luftës të kryera në Kosovë

Në mes të sesionit pranveror, deputetët e koalicionit qeverisës (përjashuar Listën Serbe) filluan iniciativat në Kuvend për të krijuar mekanizma për ndëshkimin krimeve të luftës të kryer nga shteti i Serbisë në Kosovë. Këto iniciativa erdhën pas intensifikimit të intervistave nga dhomat e specializura, të cilat derguan ftesa për disa ish pjestarë të UÇK-së dhe zyrtarë të partive politike në vend. Në seancën e 15 prillit, deputetët e Kuvendit votuan për krijimin e një Komisioni Ad Hoc, për hartimin e Projekt-Rezolutës për gjenocidin[18], krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës në Kosovë, me propozim të grupit parlamentar Nisma Socialdemokrate. Të gjitha subjektet politike, me përjashtim të Listës Serbe dërguan përfaqësues në këtë komision. Kështu, disa javë pas themelimit, më 16 maj 2019, ky Komision e dërgoi në Kuvend propozim-rezolutën për "gjenocidin serb të kryer në Kosovë". Ajo u mbështet dhe u votua nga deputetë nga të gjitha grupet parlamentare në Kuvend sërish me përjashtim të LS-së, me 79 vota "për", asnjë "kundër" dhe asnjë abstenim. [19]

Gjatë kësaj seance dhe seancës së radhës të mbajtur më 20 maj, në Kuvend u diskutua edhe për formimin e Komisionit shtetëror për krijimin e Tribunalit për gjenocidin serb në Kosovë, iniciativë e propozuar nga kryetari i Kuvendit Kadri Veseli. Megjithatë, iniciativa për krijimin e Tribunalit nuk mori përkrahjen e grupeve parlamentare të LDK-së dhe LVV-së dhe këto dy subjekte lëshuan seancën pas deklarimeve se kjo iniciativë kishte motive politike dhe jo për të ndëshkuar gjenocidin.[20] Kjo çështje u diskutua edhe në seancën e datës 30 maj ku në rend të ditës ishte votimi për formimin e Komisionit Shtetëror për krijimin e këtij Tribunali. Kjo pikë nuk iu nënshtrua procesit të votimit megjithatë, deputetët u pajtuan që Kuvendi të formonte një komision me përbërje të të gjitha grupeve parlamentare, ku do të harmonizoheshin qëndrimet rreth kësaj çështjeje dhe iniciativave tjera rreth kësaj teme.

Këto iniciativa mbetën pa ndonjë rezultat konkret pasi që disa javë më pas u shpërnda kjo legjislaturë e Kuvendit.

18 Shih përmbajtjen e kësaj Rezolute në, http://www.votaime.org/Uploads/Data/Documents/2019_05_22_Rezolutenr.017pergjenocidinekryerserbne-Kosove,dt.16.05.2019_hg4F3BvJFu.pdf

19 Shih votimin e kësaj rezolute në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/voting/vot_3_2019_05_16_10_1.pdf

20 Shih seancën e datës 16 maj 2019 në, http://www.votaime.org/Uploads/Data/Documents/trans_s_2019_05_16_10_8031_al_ëcjeUNrUHj.pdf

# 4. DIALOGU KOSOVË-SERBI NË KOMISIONE PARLAMENTARE

## 4.1. Raportimet e Ekzekutivit në Komisione

Gjatë sesionit pranveror të vitit 2019 në komisionet parlamentare janë zhvilluar katër raportime për çështje të ndërlidhura me dialogun, nga tre ministra të Qeverisë. Dy herë ka raportuar ministri i Punëve të Jashtme Behgjet Pacolli, një herë ministri i Tregtisë dhe Industrisë Endrit Shala si dhe një herë Ministri i Punëve të Brendshme Ekrem Mustafa. Temat kryesore të këtyre raportimeve ishin taksa 100% ndaj produkteve të Serbisë dhe ndikimi i saj në investimet strategjike në Kosovë, rastet e kontrabandës në veri, prezenca e mallrave serbe në tregun e brendshëm dhe pengesat e Serbisë për njohje të shtetit të Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Ministri i Punëve të Jashtme z. Behgjet Pacolli kishte raportuar para Komisionit për Integrime Evropiane dhe Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike gjatë muajit prill[21] dhe muajit maj[22]. Disa nga temat e diskutimit gjatë raportimit të tij në këto dy komisione ishin marrëdhëniet Kosovë - Serbi, më konkretisht Samiti i Berlinit, taksa 100%, pengesat nga Serbia në procesin e njohjeve të shtetit të Kosovës dhe pjesëmarrja e Kosovës në nisma rajonale. Lidhur me këto çështje ministri i kishte njoftuar anëtarët e komisioneve për aktivitetet lobuese të Serbisë në shtete të ndryshme kundër njohjes së shtetit të Kosovës. Sa i përket tërheqjes së njohjeve, ministria kishte pranuar vetëm një letër nga Ishujt Solomon për ngrirje të marrëdhënieve me Kosovën deri në përfundim të dialogut dhe jo për tërheqje të njohjes siç kishte pretenduar Serbia.[23]

> Gjatë sesionit pranveror të vitit 2019 në komisionet parlamentare janë zhvilluar katër raportime për çështje të ndërlidhura me dialogun, **nga tre ministra të Qeverisë.**

Përveç ministrit Pacolli, gjatë muajit prill kishte raportuar edhe Ministri për Punë të Brendshme Ekrem Mustafa, para Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim. Ky raportim erdhi pasi që në veri të vendit kishte pasur tensione për shkak të zgjedhjeve lokale që pritej të mbaheshin atje në muajin maj. Në kuadër të raportimit të tij bashkë me Drejtorin e Policisë Rashit Qalaj, temë e

21 Shih mbledhjen e Komisionit për Integrime Evropiane të mbajtur me 23 prill 2019 në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc__2019_04_23_12_7990_al.pdf

22 Shih mbledhjen e Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike të mbajtur më 2 maj 2019 në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc__2019_05_02_11_8004_al.pdf

23 Po aty.

diskutimit ishte gjendja e sigurisë në Kosovë dhe incidentet që kanë motive ndëretnike.[24] Ata kishin informuar anëtarët e këtij komisioni se tensionet në veri ishin në mes të grupeve kriminale, ndikimeve nga shteti serb dhe zgjedhjet lokale që pritej të mbaheshin së shpejti në atë pjesë të vendit. Sipas tyre, zbatimi i Marrëveshjes së Brukselit kishte ndikuar në situatën ekzistuese, në veri dhe meqenëse kjo çështje ishte politike, Policia kishte nevojë për asistencë politike nga institucionet tjera.

Në anën tjetër antarët e Komisionit kishin shprehur interesimin e tyre për t'u informuar lidhur me gjendjen pas taksës 100%, rastet e kontrabandës në veri dhe faktin e prezencës së mallrave serbe në treg. Lidhur me këtë çështje ministri dhe Drejtori i Policisë ishin përgjigjur se kishte raste kur kamionët nga Serbia kishin paguar taksën dhe kishin hyrë sipas procedurave ligjore. Ndërsa sa i përket kontrabandës numri i rasteve ishte në rënie.[25]

Lidhur me taksën 100% ndaj Serbisë kishte raportuar shkurtimisht edhe Minstri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, në Komisionin për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike. Anëtarët e këtij Komsioni kishin kërkuar nga ministri informacione se sa kishte ndikuar vendosja e taksës ndaj Serbisë në investimet strategjike në Kosovë nga shtetet tjera. Lidhur me këtë ministri kishte deklaruar se kjo masë nuk paraqiste pengesë për investitorët e huaj.[26]

## 4.2 Vizitat në terren të Komisioneve për monitorimin e zbatimit të marrëveshjeve të Dialogut

Në kuadër të aktiviteteve mbikëqyrëse komisionet parlamentare gjatë këtij sesioni organizuan dy vizita në terren, me qëllim të informimit të anëtarëve të komisionit për çështje të ndërlidhura me dialogun.

Në muajin qershor kur pritej edhe përmbyllja e transferimit të kodit telefonik të Kosovës +383, Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal me mbështetje të Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), realizoi një vizitë në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP).[27] Qëllimi i kësaj vizite ishte informimi i anëtarëve të këtij komisioni për zbatimin e marrëveshjes së Brukselit të arritur në vitin 2013 për telekomunikacionin dhe kodin telefonik +383. Gjatë kësaj vizite ata shprehën interesimin e tyre rreth zbatimit të kësaj marrëveshjeje dhe ngecjet në këtë proces, përfitimet e Kosovës nga kjo marrëveshje, sfidat nga operatorët telefonik për zbatimin e saj si dhe funksionalizimin e kodit +383. Ata u informuan nga përfaqësuesit e ARKEP-it, se kjo marrëveshje ishte zbatuar në masë të madhe, megjithatë një pjesë e saj mbetej ende e pazbatuar. Po ashtu, ata u njoftuan se operatorët ekonomik në Kosovë PTK dhe IPKO po përballeshin me sfida në adoptimin e kodit +383. Veçanërisht, kompania publike PTK, kishte probleme në zbatimin e kodit gjë për të cilën anëtarët e Komisionit u zotuan se do të ngrisin këtë çështje edhe në mbledhjet e Komisionit. Kjo çështje u ngrit në mbledhjen e radhës të Komisionit e mbajtur më 25 qershor, në të cilën anëtarët e Komisionit vendosën që të

24 Shih mbledhjen e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim të mbajtur më 24 prill 2019, në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc__2019_04_24_11_7992_al.pdf

25 Po aty.

26 Shih mbledhjen e Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike të mbajtur më 5 prill 2019 në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc__2019_04_05_10_7960_al.pdf

27 Shih komunikatën për shtyp të KDI-së të datës 18 qershor 2019 në platformën Vota Ime në, http://www.votaime.org/Public/DialogActivity/Detail/344

realizojnë një vizitë edhe në PTK, me propozim të KDI-së, për t'u informuar se a po zbatohej kodi telefonik.[28] Megjithatë, kjo vizitë nuk u realizua për shkak të zhvillimeve politike në fund të sesionit pranveror.

Në anën tjetër, pas vizitës së realizuar në ARKEP, komisioni në mbledhjen e tij të mbajtur më 16 korrik, ftoi në raportim kryetarin e ARKEP-it Kreshnik Gashi në kuadër të shqyrtimit të raportit vjetor të këtij institucioni për vitin 2018. Qëllimi i këtij raportimi sipas kryetarës së komisionit ishte edhe informimi rreth kodit telefonik +383, i anëtarëve të tjerë të komisionit dhe pjesëmarrësve që nuk kanë mundur të marrin pjesë në vizitën e realizuar në ARKEP.[29] Z. Gashi kishte raportuar se me gjithë faktin se ARKEP kishte kryer të gjitha detyrimet shtetërore në raport me operatorët, procesi i implementimit të plotë të kodit +383 nuk ishte përmbyllur ende dhe ARKEP ishte detyruar të gjobisë operatorët e telefonisë, me qëllim të përmbylljes sa më të shpejtë të këtij procesi. Ndërsa anëtarët e komisionit, ishin interesuar të dinin se deri në çfarë mase ishte zbatuar kodi +383 dhe pse ende në Kosovë mund të pranoheshin sms me kodet e vjetra telefonike.[30]

Përveç Komisionit për Zhvillim Ekonomik edhe Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi, si dhe Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media realizuan një vizitë në terren në Luginën e Preshevës më 5 qershor.

Në mbledhjen e përbashkët të mbajtur nga Komisioni për Arsim dhe Komisioni për Administratë pas realizimit të kësaj vizite, kryetarët e dy komisioneve njoftuan anëtarët e tjerë për detajet nga kjo vizitë. Ndër të tjera, u përmend gjendja e vështirë e shqipëtarëve atje, mungesa e teksteve shkollore, mosnjohja e diplomave çështje kjo që lidhet me marrëveshjen e Brukselit për njohjen reciproke të diplomave. Anëtarët e komisionit kërkuan vendosjen e reciprocitetit ndaj Serbisë sa i përket të drejtave të komuniteteve.[31]

> Në kuadër të aktiviteteve mbikëqyrëse komisionet parlamentare gjatë këtij sesioni organizuan dy vizita në terren, **me qëllim të informimit të anëtarëve të komisionit për çështje të ndërlidhura me dialogun.**

Vlen të theksohet se para kësaj vizite, Komisioni për Arsim, me propozim të KDI-së, kishte të planifikuar edhe një vizitë në Ministrinë e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT). Qëllimi i kësaj vizite ishte informimi i anëtarëve të Komisionit rreth gjendjes së zbatimit të marrëveshjeve të Brukselit që lidhen me fushën e arsimit, siç janë njohja reciproke e diplomave, statuti i Universitetit të Mitrovicës së Veriut, plan programet arsimore në komunat serbe, tekstet shkollore për Luginën e Preshevës, Ligji për Arsimin e Lartë dhe lidhshmëria e tij me marrëveshjet e Brukselit. Megjithatë, pas caktimit të datës së kësaj vizite, ajo u anulua një ditë para nga ana e Ministrisë dhe pavarësisht kërkesave të vazhdueshme të Komisionit dhe KDI-së për të caktuar një datë tjetër, Ministria e Arsimit nuk pati gatishmëri për realizimin e kësaj vizite.[32]

28 Shih mbledhjen e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal të mbajtur më 25 qershor 2019 në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc__2019_06_25_13_8108_al.pdf

29 Shih mbledhjene Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal të mbajtur më 16 korrik 2019 në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc__2019_07_16_11_8150_al.pdf

30 Po aty.

31 Shih mbledhjen e këtyre Komisioneve të mbajtur më 25 qershor 2019 në, http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,128,10699

32 KDI ka qenë në komunikim të vazhdueshëm me zyrtarët e Ministrisë së Arsimit gjatë muajit maj dhe qershor, lidhur me organizimin e vizitës së anëtarëve të Komisionit për Arsim në këtë Ministri, megjithatë pavarësisht përpjekjeve nuk ka marrë një përgjigje pozitive nga kabineti i ministrit për realizimin e kësaj vizite. Arsyetimi nga ana e Ministrisë ka qenë se agjenda e ministrit është e zënë.

## 4.3 Çështjet tjera rreth dialogut të diskutuara në Komisionet Parlamentare

### 4.3.1 Komisioni për Buxhet dhe Financa

Gjatë sesionit pranveror, Komisioni për Buxhet dhe Financa diskutoi rreth çështjeve të ndërlidhura me dialogun në dy prej mbledhjeve të tij, nga gjithsej 17 mbledhje të mbajtura gjatë kësaj periudhe. Në njërën nga dy mbledhjet tema e dialogut ishte edhe pikë e rendit të ditës, në të cilën u bë shqyrtimi i Projektligjit për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror dhe amendamenteve të Komisionit për Punën të Jashtme. Pas diskutimit komisioni nxori edhe një rekomandim përmes të cilit u konkludua se, ky projektligj dhe amandamentet e propozuara nga Komisioni për Punë të Jashtme nuk përmbanin implikime buxhetore shtesë, përveç shumës që ishte ndarë paraprakisht nga Qeveria, në vlerë prej rreth 300 mijë eurosh.[33]

Ky komision ngriti çështjen e dialogut edhe në mbledhjen e mbajtur më 29 maj, në kuadër të pikës të rendit të ditës lidhur me shqyrtimin e kërkesës së Drejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për caktimin e lartësisë së koeficientit dhe të pagës së Drejtorit dhe Zëvendës-Drejtorit të kësaj Agjencie. Lidhur me këtë, deputetja nga radhët e subjektit LVV kishte deklaruar se ky subjekt ishte kundër vendimit për funksionalizimin e kësaj Agjencie ashtu siç ishte rregulluar me ligj, pasi që kjo Agjenci ishte rezultat i marrëveshjeve të Brukselit.[34] Sipas saj, mënyra siç ishte rregulluar çështja e kthimit të dokumentacionit dhe pronave, ishte në interes të Serbisë dhe personave që kanë keqpërdorur me prona.[35]

### 4.3.2 Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim

Gjatë sesionit pranveror, Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim ngriti çështjet e ndërlidhura me dialogun në tri nga 11 mbledhje të mbajtura. Në dy prej tyre kjo temë ishte edhe pikë e rendit të ditës.

Ky komision kishte përfshirë çështjet e ndërlidhura me procesin e dialogut edhe në planin e tij të punës të miratuar në fillim të sesionit pranveror. Më konkretisht, në mbledhjen e parë të mbajtur me 28 janar kryetari i këtij komisioni kishte kërkuar që në javën e parë të muajit shkurt, të realizohej vizita në komunën e Zubin Potokut, ndërsa pas dy javë në komunën e Leposaviqit. Sipas tij kjo çështje ishte në interes për zhvillimin e procesit të dialogut, dhe veçmas akomodimi i kërkesave të komuniteteve tjera.[36] Megjithatë, nga përmbajtja e procesverbaleve nga mbledhjet e këtij komisioni të publikuara në uebfaqën zyrtare të Kuvendit, nuk ka ndonjë infomacion lidhur me atë se a janë realizuar këto vizita në dy komunat respektive.

Në një nga mbledhjet e tij, ky komision kishte shqyrtuar edhe Projektligjin për Delegacionin Shtetëror me raport amendamente të Komisionit funksional për Punë të Jashtme. Në kuadër të kësaj pike, komisioni kishte nxjerrë një rekomandim me anë të të cilit, kishte konkluduar se ky

33 Shih mbledhjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa të mbajtur më 6 mars 2019 në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc__2019_03_06_16_7935_al.pdf

34 Agjencisa Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës është pjesë e marrëveshjes së Brukselit për Regjistrin Kadastral. Shih përmbajtjen e kësaj marrëveshjeje në Modulin Dialogu Kosovë - Serbi në platformën Vota Ime, në http://www.votaime.org/Uploads/Data/Documents/TekstiiMarreveshjes_2shtator2011_cdzyAf5Dk8.pdf

35 Shih mbledhjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa të mbajtur më 29 maj 2019 në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc__2019_05_29_11_8057_al.pdf

36 Shih mbledhjen e Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim të mbajtur më 28 janar 2019 në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc__2019_01_28_12_7844_al.pdf

Projektligj me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, nuk cenonin dhe nuk preknin të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Prandaj, u rekomandua që i njejti të procedohej për miratim në Kuvend.[37]

### 4.3.3 Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit

Gjatë këtij sesioni, Komisoni për Legjislacion kishte temë të diskutimeve dialogun me Serbinë në tri mbledhje të tij, nga gjithsej 20 mbledhje dhe dëgjime publike të mbajtura. Në dy prej mbledhjeve, çështja e dialogut ishte edhe pikë e rendit të ditës. Në mbledhjen e komisionit të mbajtur më 5 shkurt, në të cilën u bë shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së komisionit për vitin 2019, u propozua që mbikëqyrja e procesit të dialogut të bëhet pjesë e planit të punës, sipas propozimeve të KDI-së. Në kuadër të këtij diskutimi, anëtarët e komisionit që ishin nga grupi parlamentar i PSD-së, e vlerësonin si zhvillimin më të rëndësishëm faktin që pas miratimit të rezolutës për dialogun në dhjetor të vitit 2018, ky proces do t'i nënshtrohej monitorimit të drejtpërdrejtë nga Kuvendi. Megjithatë, edhe pse pritej të krijohej një komision i veçantë në këtë drejtim, sipas tyre, ishte e domosdoshme që dialogu të monitorohej nga të gjitha komisionet.[38]

Mbikëqyrja e dialogut ishte pikë e rendit të ditës edhe në mbledhjen e mbajtur më 6 mars, në kuadër të së cilës u shqyrtua raporti me amendamente për Projektligjin për Delegacionin Shtetëror. Në fund të diskutimit anëtarët e komisionit përkrahën këtë raport dhe amandamentet përkatëse.[39]

### 4.3.4 Komisioni për Integrime Evropiane

Gjatë sesionit pranveror, Komisioni për Integrime diskutoi lidhur me çështjen e dialogut në tri mbledhje të tij nga gjithsej 15 mbledhje të mbajtura. Në dy prej mbledhjeve, çështja e dialogut ishte edhe pikë e rendit të ditës. Ky komision kishte përfshirë temën e dialogut edhe në planin e tij të punës të miratuar në fillim të vitit 2019. Më konkretisht, në këtë plan parashihej raportimi i ministrit të Punëve të Jashtme lidhur me procesin e anëtarësimit të Kosovës në organizata të ndryshme rajonale dhe ndërkombëtare. Kjo çështje ndërlidhej me marrëveshjen e Brukselit për përfaqësim dhe bashkëpunim rajonal. Kështu, Ministri i Punëve të Jashtme Behgjet Pacolli u ftua në raportim në mbledhjen e datës 23 prill, për të raportuar lidhur me procesin e integrimit evropian. Gjatë këtij diskutimi ai u pyet edhe për çështjen e anëtarësimit të Kosovës në organziata rajonale dhe ndërkombëtare dhe pengesat nga Serbia në këtë drejtim. Detajet nga ky raportim janë të përshkruara në seksionin përkatës më lartë.

Një nga temat e rëndësishme lidhur me dialogun, që ishte pikë e rendit të ditës në një nga mbledhjet e këtij komisioni, ishte shqyrtimi i projektligjit për Delegacionin Shtetëror. Në kuadër të këtij diskutimi të datës 6 mars, komisioni nxori rekomandimin se, Projektligji për Delegacionin Shtetëror me amendamentet e Komisionit funksional nuk ishte në kundërshtim me legjislacionin e BE-së. Prandaj, i njejti mund të rekomandohej për miratim në Kuvend.[40]

37 Shih mbledhjen e Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim të mbajtur më 7 mars 2019 në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc__2019_03_07_09_7985_al.pdf

38 Shih mbledhjen e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit të mbajtur më 5 shkurt 2019 në,

39 Shih mbledhjen e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit të mbajtur më 6 mars 2019 në, http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,128,10380

40 Shih mbledhjen e Komisionit për Integrime Evropian të mbajtur më 6 mars 2019 në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc__2019_03_06_16_7984_al.pdf

### 4.3.5 Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike

Çështjet e ndërlidhura me procesin e dialogut Kosovë - Serbi u diskutuan në Komisionin për Punë të Jashtme në tetë nga 13 mbledhje dhe dëgjime publike të mbajtura gjatë sesionit pranveror. Në gjashtë prej mbledhjeve çështja e dialogut ishte e përcaktuar edhe në rendin e ditës. Për më tepër çështjet e ndërlidhura me dialogun ishin edhe pjesë e planit të punës së këtij komisioni. Më konkretisht, komisioni përfshiu në këtë plan përcjelljen e procesit të negocimit dhe sigurimin e rolit të komisionit si dhe shqyrtimin e Projektligjit për Delegacionin. Kjo e fundit ishte edhe tema kryesore që mbizotëroi shumicën e diskutimeve në mbledhjet e këtij komisioni, përkatësisht në katër nga tetë mbledhjet ku u ngritë çështja e dialogut.

Komisioni shqyrtoi Projektligjin për Delegacionin Shtetëror për herë të parë me 30 janar, me ç'rast me gjashtë vota "për" dhe tri vota "kundër", i rekomandoi Kuvendit që Projektligji në fjalë të miratohej në parim. Në mbledhjen e radhës të datës 25 shkurt, komisioni shqyrtoi sërish këtë Projektligj së bashku me Platformën për Dialogun. Në fund të mbledhjes, u miratua raporti me rekomandime për Projektligjin për Delegacionin Shtetëror me pesë vota "për" dhe katër vota "kundër". Ndërsa, lidhur me Platformën për Dialogun, komisioni nuk mori vendim në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për votim. Me rastin e votimit, vetëm pesë deputetë morën pjesë në votim dhe mbështetën këtë Platfomë edhe pse fizikisht në mbledhje ishin të pranishëm nëntë deputetë.

Projektligji dhe Platforma u diskutuan sërish më 6 mars, ku amendamentet e propozuara nga deputeti Dukagjin Gorani u përkrahen unanimisht nga anëtarët e pranishëm në mbledhjen e komisionit. Po ashtu, raporti me rekomandime lidhur me Projektligjin iu përcollë komisioneve të përhershme për shqyrtim sipas fushëveprimit të tyre. Për më tepër edhe Platforma për Dialogun u miratua njëzëri nga anëtarët e pranishëm në mbledhjen e komisionit dhe u procedua tutje në Kuvend. Projektligji për Delgacionin u shqyrtua edhe në mbledhjen e 7 marsit, me ç'rast raporti me rekomandime për Projektligjin u miratua njëzëri dhe u procedua tutje në Kuvend.

### 4.3.6 Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal

Gjatë këtij sesioni, Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal diskutoi lidhur me çështjen e dialogut në nëntë nga 22 mbledhjet dhe dëgjimet publike të mbajtura. Në dy prej mbledhjeve dialogu ishte edhe pikë e rendit të ditës, ndërsa në shtatë prej tyre ajo u diskutua në kuadër të pikës të ndryshme ose pikave tjera të rendit të ditës. Ky bilanc e bën këtë komision me nivelin më të lartë të diskutimeve rreth kësaj teme.

Temat më të diskutura rreth dialogut kanë qenë marrëveshjet e Brukselit për energji dhe për telekomunikacionin. Në dëgjimin publik të datës 10 prill për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Energjinë Elektrike, anëtarët e këtij komisioni ngritën çështjen e antarësimit të KOSTT-it në ENTSO-E dhe problemet që sjell mungesa e anëtarësimit, si pjesë e marrëveshjes për energji.[41] Përveç në këtë mbledhje, anëtarët e këtij komisioni kishin shprehur interesimin rreth zbatimit të kësaj marrëveshjeje edhe në mbledhje tjera. Kështu, pas informacioneve se Qeveria kishte arritur të regjistronte operatorin e veriut për energji elektrike, anëtarë të komisionit kishin kërkuar nga komisioni që të kërkonte informata nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) rreth kësaj çështje. Më konkretisht, se si ishte regjistruar kjo kompnai duke qenë se ata asnjëherë nuk i ishin referuar Kosovës sipas ligjeve dhe Kushtetutës së Kosovës, si

41 Shih mbledhjen e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal të mbajtur më 10 prill 2019 në, http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,159&date=2019-04-10

ishte gjetur forma e regjistrimit, nëse ishte regjistruar dhe a ishin respektuar ligjet. Për më teprë anëtarë të komisionit kishin kërkuar që të organizohet një takim i veçantë i komisionit me autoritetet e Brukselit, ose edhe me përfaqësues të komisioneve të tjera për të kërkuar zbatimin e marrëveshjes.[42]

Anëtarët e këtij komisioni kishin ngritur çështjen e moszbatimit të Marrëveshjes për Energji nga ana e Serbisë edhe në takime me përfaqësues ndërkombëtar. Kështu, në kuadër të takimit të komisionit me Janez Kopaç, drejtor i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, më 12 shkurt, kryetarja e këtij komisioni e kishte njoftuar atë se Serbia nuk po e respektonte marrëveshjen.[43]

Në ushtrimin e funksionit mbikëqyrës ndaj procesit të dialogut ky komision kishte realizuar një vizitë në ARKEP dhe kishte ftuar në raportim zyrtarë të lartë të kësaj kompanie. Këto dy aktivitete ishin realizuar me qëllim të monitorimit të gjendjes së zbatimit të Marrëveshjes së Brukselit për Telekomunikacionin. Detajet e këtyre aktiviteteve janë të përshkruara në seksionet përkatëse.

### 4.3.7 Diskutimet rreth dialogut në Komisione tjera

Gjatë sesionit pranveror, komisionet parlamentare që trajtuan më pak çështjet e ndërlidhura me dialogun ishin, Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi, Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor, Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media dhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione. Ndërsa, Komisionet që nuk diskutuan fare për çështjet e ndërlidhura me dialogun ishin, Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Këto komisione nuk i kushtuan vëmendjen e nevojshme temës së dialogut edhe pse disa nga marrëveshjet e dialogut bien në fushëveprimin e këtyre Komisioneve.

**Komisioni për Arsim:** ngriti çështjen e dialogut gjatë planifikimit të vizitës në MASHT, në mbledhjen e datës 15 maj si dhe në mbledhjen e datës 25 qershor pas kthimit nga vizita në Luginën e Preshevës. Detajet e këtyre aktiviteteve janë të përshkruara në seksionin e vizitave në terren.

**Komisioni për Bujqësi:** diskutoi për çështje të ndërlidhura me dialogun në dy mbledhje të tij. Më konkretisht anëtarët e këtij komisioni shprehën interesimin e tyre për zbatimin e taksës 100% ndaj Serbisë si dhe gjendjen e pagesës së faturave të ujit në pjesën veriore.

**Komisioni për Shëndetësi:** ngriti temën e dialgut në një nga mbledhjet e mbajtura. Kështu, në kuadër të raportimit të Ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale Skender Reçica, lidhur me reformën e sistemit pensional në Kosovë, anëtarët e komisionit shprehën interesimin të dinin lidhur me fondin pensional të marrë nga Serbia dhe si do të adresohej kjo çështje.

**Komisioni për Administratë Publike:** ngriti çështjen e dialogut vetëm në mbledhjen e përbashkët të mbajtur me Komisioni për Arsim pas vizitës së realizuar në Luginën e Preshevës nga këto dy komisione.

**Komisioni për të Drejtat e Njeriut:** diskutoi çështjet që ndërlidhen me dialogun në tri mbledhje të tij. Anëtarët e Komisionit ngritën temën e personave të pagjetur në kuadër të diskutimeve mbi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Persona të Zhdukur.

42 Shih mbledhjen e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal të mbajtur më 22 janar 2019 në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc__2019_01_22_11_7829_al.pdf

43 Shih mbledhjen e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal të mbajtur më 12 shkurt 2019 në, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc__2019_02_12_13_7873_al.pdf

# 5. PËRFUNDIM DHE REKOMANDIME

Gjatë sesionit pranveror të Kuvendit të Kosovës në vitin 2019, çështjet që ndërlidhen me procesin e dialogut Kosovë-Serbi u diskutuan gjerë në seancat plenare, por jo edhe në mbledhjet e komisioneve parlamentare. Epilogu i disa prej diskutimeve ishte miratimi i Ligjit për Delegacionin Shtetëror dhe i Platformës për Dialogun, ndonëse jo me konsensus të gjerë të partive parlamentare, që vlerësohet si shumë i nevojshëm për fazën e re të dialogut me Serbinë. Në anën tjetër deputetët e Kuvendit arritën të dëshmojnë konsensus në miratimin e një rezolute për gjenocidin serb të kryer në Kosovë.

Ideja e 'korrigjimit të kufijve' e ndau spektrin politik rreth veprimeve që Kuvendi i Kosovës duhet të ndërmerrte për të adresuar këtë çështje, e cila sipas deklaratave publike të partive politike, nuk kishte mbështetjen e tyre. Propozim-rezoluta e LDK, LVV dhe Alternativa me një pikë të vetme që synonte të ndalonte angazhimet e Presidentit në këtë drejtim nuk iu nënshtrua procesit të votimit në Kuvend, në mungesë kuorumi. Ndërsa, Rezoluta e propozuar nga PSD dhe e mbështetur nga koalicioni qeverisës u miratua në Kuvend me votat e këtyre partive, pa mbështetjen e dy partive të tjera opozitare dhe adresoi si në Rezolutë ashtu dhe në Platfomën për Dialogun, e cila u miratua më vonë, çështjen e integriteti territorial të Republikës së Kosovës si të pacenueshëm.

Deputetët e Kuvendit shfrytëzuan minimalisht mekanizmat mbikëqyrës ndaj ekzekutivit lidhur me procesin e dialogut. Vetëm shtatë pyetje parlamentare, asnjë interpelancë dhe vetëm një debat parlamentar rreth kësaj teme u konkretizuan. Në komisionet parlamentare u ftuan tre ministra në gjithsej katër raportime për çështjet e ndërlidhura me dialogun. Tri nga komisionet parlamentare kishin përfshirë çështjet e ndërlidhura me dialogun edhe në planet e tyre të punës duke realizuar kështu dy vizita në terren për të monitoruar nga afër gjendjen e zbatimit të marrëveshjeve të dala nga procesi i dialogut.

Dialogu Kosovë-Serbi ishte i pezulluar gjatë gjithë periudhës sa zgjati sesioni pranveror i Kuvendit të Kosovës. Në fund të këtij sesioni u shpërnda edhe Legjislatura e gjashtë, pa një konsensus të gjerë të spektrit politik dhe ide të qartë se cila duhej të ishte qasja dhe kërkesat e Kosovës ndaj fazës së re të dialogut me Serbinë.

Duke pasur parasysh që procesi i dialogut pritet të vazhdojë në një të ardhme të afërt, KDI ofron rekomandimet e mëposhtme për Legjislaturën e re të Kuvendit të Kosovës:

1. Deputetët e Legjislaturës së re, duhet të tregojnë vullnet drejtë ndërtimit të konsensusit rreth qasjes unike shtetërore në raport me fazën përfundimtare të dialogut Kosovë-Serbi. Qëndrimet e tyre duhet të jenë në përputhje me mandatin e tyre kushtetues dhe imune ndaj kalkulimeve partiake.

2. Në bazë të mandatit të tij, Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet të ushtroj rolin e tij mbikëqyrës në procesin e dialogut Kosovë-Serbi. Deputetët e Kuvendit duhet të jenë më proaktiv në mbikëqyrjen e ekzekutivit duke shfrytëzuar mekanizmat mbikëqyrës parlamentar, përmes pyetjeve parlamentare, debateve parlamentare, interpelancave dhe rezolutave lidhur me çështjen e dialogut.

3. Komisionet parlamentare, në bazë të fushëveprimit të tyre, duhet të integrojnë në planet e tyre vjetore të punës ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse ndaj institucioneve përgjegjëse që ndërlidhen me marrëveshjet tashmë të arritura si dhe të artikulojnë qëndrime rreth fazës së ardhshme të këtij procesi. Ftesat për raportime për institucionet përkatëse në komisione, iniciativat në seanca plenare, vizitat në terren që ndërlidhen me marrëveshjet e dialogut, dëgjimet publike si dhe takimet me qytetarët duhet të shërbejnë si mekanizma për fuqizim të rolit të komisioneve parlamentare në këtë proces.

4. Komisionet duhet të vazhdojnë praktikën e mirë të organizimit të takimeve koordinuese si një platformë diskutimi, bashkërendimi dhe dakordësimi në mes të komisioneve rreth rolit të tyre në procesin e dialogut, bashkëpunimit të ndërsjellë në monitorimin, mbikëqyrjen, pjesëmarrjen dhe avancimin e transparencës së këtij procesi, duke u bazuar në rezolutat e Kuvendit të Kosovës.

# 6. ANEKS

**TAB. 1.1** Dialogu në Seancat e Legjislaturës së Gjashtë gjatë sesionit pranveror të vitit 2019

| Nr. | Data | Seanca | Rend Dite/ Jashtë rendit të ditës | Pikat | Çështjet e Diskutimit |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 30 janar 2019 | Plenare | Rend Dite | 1. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e "shkëmbimit të territoreve" apo "korrigjim të kufijve" në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë;<br>2. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetit Korab Sejdiu, lidhur me nevojën urgjente për vendosje të sanksioneve ekonomike (përfshirë embargon) dhe sanksioneve politike kundër Serbisë, si masë reciprociteti; | Dy pikat u shtyen për seanca tjera;<br>U diskutuan faza e re e dialogut dhe taksa 100%; |
| 2 | 2 shkurt 2019 | Plenare | Rend Dite | Shqyrtimi i parë i Projektligjit për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë; | U miratua në parim Projektligjin me 61 vota "për"; |
| 3 | 17 shkurt 2019 | Solemne | Diskutim | | U përmendën marrëdhëniet me Serbinë gjatë fjalimeve për përvejtorin e pavarësisë së Kosovës; |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 4 | 28 shkurt 2019 | vazhdim i seancës plenare | **Rend Dite** | Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e "shkëmbimit të territoreve" apo "korrigjim të kufijve" në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë; | Kjo pikë nuk u diskutua; |
| 5 | 7 mars 2019 | E jashtëzakonshme | **Rend Dite** | 1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë;<br>2. Shqyrtimi i Platformës për dialogun mbi Marrëveshjen përfundimtare gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë; | Votimi i dy pikave u shtye në sencën plenare të radhës të mbajtur në të njëjtën ditë; |
| 6 | 7 mars 2019 | Plenare | **Rend Dite** | 1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë;<br>2. Shqyrtimi i Platformës për dialogun mbi Marrëveshjen përfundimtare gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë; | Projektligji u votua nga 61 deputetë, 58 "për" dhe 3 abstenime; Platforma u votua me 61 vota "për" dhe 1 abstenim; |
| 7 | 12 mars 2019 | vazhdim i seancës plenare | **Diskutim** | | Dialogu me Serbinë në përgjithësi; |
| 8 | 13 mars 2019 | E jashtëzakonshme | **Diskutim** | | Udhëheqja e dialogut nga Presidenti; |
| 9 | 11 prill 2019 | E jashtëzakonshme | **Diskutim** | | Dialogu me Serbinë si kusht për liberalizim të vizave; |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 10 | 12 prill 2019 | Plenare | Rend Dite | Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetit Korab Sejdiu, lidhur me nevojën urgjente për vendosje të sanksioneve ekonomike (përfshirë embargon) dhe sanksioneve politike kundër Serbisë, si masë reciprociteti; | Taksa 100%;<br><br>Vendosja e reciprocitetit ndaj Serbisë;<br>Çështja e kthimit të Fondit Pensionit të Kosovës nga Serbia; |
| 11 | 15 prill 2019 | Plenare | Rend Dite | Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e "shkëmbimit të territoreve" apo "korrigjim të kufijve" në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë; | Pika e rendit te ditës nuk pati kuroum për votim;<br>Propozimi për krijimin e një komision ad hoc nga Kuvendi për përgatitjen e një rezolute për gjenocidin; çështja e dorëzimit të kriminelëve të luftës nga ana e Serbisë; |
| 12 | 14 maj 2019 | E jashtëzakonshme | Diskutim | | Kodi telefonik +383; |
| 13 | 15 maj 2019 | Plenare | Rend Dite | Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e "shkëmbimit të territoreve" apo "korrigjim të kufijve" në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë; | Kjo pikë nuk u diskutua; |
| 14 | 16 maj 2019 | Plenare | Rend Dite | 1. Shqyrtimi i Propozim-Rezolutës për gjenocidin, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës të ish-regjimit shtetëror serb në Kosovë; 2. Formimi i Komisionit shtetëror për krijimin e Tribunalit për gjenocidin serb në Kosovë; 3. Vendimi për ndërtimin e Muzeut të Gjenocidit, tek ish - Fabrika e Tjegullave; 4. Vendim për ndërtimin e Memorialit të Dëbimit, te Stacioni Hekurudhor i Prishtinës; 5. Caktimi i Ditës së Gjenocidit; | Në kuadër të pikës 1 u diskutua në përgjithësi për raportet me Serbinë dhe të kaluarën;<br>U miratua Rezoluta për gjenocidin e kryer serb në Kosovë, me 79 vota "për";<br>Në kuadër të pikës 2 u diskutua mundësia e krijimit të Tribunalit për gjenocidin serb;<br>3 pikat e tjera të rendit të ditës nuk u diskutuan; |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 15 | 20 maj 2019 | vazhdim i seancës plenare | **Rend Dite** | Formimi i Komisionit shtetëror për krijimin e Tribunalit për gjenocidin serb në Kosovë; | Ky komision nuk u formua pasi që LDK dhe LVV nuk e mbështetën dhe braktisën seancën; |
| 16 | 21 maj 2019 | E veçantë | **Rend Dite** | Përkujtimi i 20-vjetorit të Masakrës në Burgun e Dubravës; | Raportet me Serbinë dhe të kaluarën; |
| 17 | 30 maj 2019 | Plenare | **Rend Dite** | 1. Votimi për formimin e Komisionit Shtetëror për krijimin e Tribunalit për gjenocidin serb në Kosovë;<br>2. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e "shkëmbimit të territoreve" apo "korrigjim të kufijve" në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë; | Në kuadër të pikës 1 sërish u diskutua krijimi i një Tribunali për gjenocid;<br>Për pikën 2 nuk pati kuorum; |
| 18 | 19 qershor | Plenare | **Rend Dite** | Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e "shkëmbimit të territoreve" apo "korrigjim të kufijve" në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë; | Serish nuk pati kuorum për votimin e kësaj pike; |
| 19 | 24 qershor 2019 | E jashtëzakonshme | **Diskutim** | | Raporti i Dick Martit, që u konsiderua si goditje nga Serbia; |
| 20 | 27 qershor 2019 | E jashtëzakonshme | **Diskutim** | | Pengesat nga Serbia për sportistët e Kosovës; |
| 21 | 28 qershor 2019 | E jashtëzakonshme | **Diskutim** | | Lgji për dialog që u cilësua antikushtetues;<br>Përgjegjësia e Kryeministrit për dialog; |
| 22 | 1 korrik 2019 | E jashtëzakonshme | **Rend Dite** | Situata aktuale e shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë - angazhimi i institucioneve të Republikës së Kosovës për të drejtat dhe vështirësitë e tyre; | Dialogu në përgjithësi;<br><br>Çështja e mosnjohjes së diplomave nga Serbia; |

| | PARASHTRUESI | DREJTUAR PËR | PËRGJIGJUR | TEMA E PYETJES |
|---|---|---|---|---|
| 12 prill 2019 | Armend Zemaj - LDK | Ramush Haradinaj<br>Kryeministër | Jo | Fuqizimi i subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës; |
| 12 prill 2019 | Ganimete Musliu - PDK | Endrit Shala<br>Ministër i Tregtisë | Po | Prezenca e produkteve serbe në treg pas vendosjes së taksës 100%; |
| 30 janar 2019 | Ismajl Kurteshi - LVV | Kujtim Gashi<br>Ministër i Kulturës | Po | Regjistrimi i instrumentit shqiptar, lahutës në UNESCO nga Serbia; |
| 30 janar 2019 | Xhelal Sveçla - LVV | Bedri Hamza<br>Ministër i Financave | Po | Përfitimet nga taksa 100%; |

| | PARASHTRUESI | DREJTUAR PËR | PËRGJIGJUR | TEMA E PYETJES |
|---|---|---|---|---|
| 30 janar 2019 | Xhelal Sveçla - LVV | Bedri Hamza<br>Ministër i Financave | Po | Prezenca e produkteve serbe në treg pas vendosjes së taksës 100%; |
| 31 janar 2019 | Armend Zemaj - LDK | Ramush Haradinaj<br>Kryeministër | Jo | Fuqizimi i subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës; |
| 30 janar 2019 | Salih Zyba - LVV | Bedri Hamza<br>Ministër i Financave | Jo | Kontrabanda pas vendosjes së taksës 100%; |

**TAB. 1.2** Pyetjet Parlamentare rreth Dialogut në sesionin pranveror 2019

**TAB. 1.3** Dialogu në mbledhjet e Komisionit për Buxhet dhe Financa

| Nr. | Data | Rend Dite/ Diskutim | Pika | Çështja e Diskutimit |
|---|---|---|---|---|
| 1 | 6 mars 2019 | **Rend Dite** | Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë dhe amendamenteve të Komisionit Funksional për Punën të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike; | Rekomandim:<br>1. Projektligji nuk përmban implikime buxhetore shtesë;<br>2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional për Punë të Jashtme, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë; |
| 2 | 29 maj 2019 | **Diskutim** | | Marrëveshja e Brukselit për regjistrin kadastral; |

**TAB. 1.4** Dialogu në mbledhjet e Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim

| Nr. | Data | Rend Dite/ Diskutim | Pika | Çështja e Diskutimit |
|---|---|---|---|---|
| 1 | 28 janar 2019 | **Diskutim** | | Planifikim i vizitave në KK të Zubin Potoku dhe KK të Leposaviqit, si çështje në interes për zhvillimin e procesit të dialogut; |
| 2 | 7 mars 2019 | **Rend Dite** | Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë, me raport amendamente të Komisionit funksional për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike. | Rekomandim: Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend; |
| 3 | 24 prill 2019 | **Rend Dite** | Raportimi i Ministrit të Punëve të Brendshme, z. Ekrem Mustafa, lidhur me gjendjen e sigurisë në Kosovë dhe incidentet që kanë motive ndëretnike; | Taksa 100%;<br>Rastet e kontrabandës në veri dhe faktin e prezencës së mallrave serbe në biznese;<br>Gjendjen e sigurisë në Veri ku prezent veç ministrit ishte edhe drejtori i Policisë Rashit Qalaj; |

**TAB. 1.5** Dialogu në mbledhjet e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikqyrjen e Agjencisë kundër Korrupcionit

| Nr. | Data | Rend Dite/Diskutim | Pika | Çështja e Diskutimit |
|---|---|---|---|---|
| 1 | 5 shkurt 2019 | Rend Dite | Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së komisionit për vitin 2019 | Përfshirja e temës së dialogut në planin e punës, me propozim të KDI-së; Nevoja për mbikëqyrje të dialogut nga të gjitha Komisionet; |
| 2 | 12 shkurt 2019 | Diskutim | | Dënimi në mungesë i kriminelëve të luftës që jetojn në Serbi; |
| 3 | 6 mars 2019 | Rend Dite | Shqyrtimi i raportit me amendamente në Projektligjin nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë | Komisioni shqyrtoi dhe përkrahu raportin me amendamente në këtë Projektligj; |

**TAB. 1.6** Dialogu në mbledhjet e Komisionit për Integrime Evropiane

| Nr. | Data | Rend Dite/Diskutim | Pika | Çështja e Diskutimit |
|---|---|---|---|---|
| 1 | 4 mars 2019 | Diskutim | | Ndërlidhja e liberalizimit të vizave me dialogun me Serbinë; Taksa 100%; |
| 2 | 6 mars 2019 | Rend Dite | Shqyrtimi i Projektligjin nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësit dhe kompetencat e Delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së. | Rekomandim: Projektligji me amendamentet e Komisionit funksional, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, prandaj u rekomandua për miratim në Kuvend; |
| 3 | 23 prill 2019 | Rend Dite | Raportimi i z. Behgjet Pacolli, zëvendëskryeministër i parë dhe ministër I Punëve të Jashtme, lidhur me procesin e integrimit evropian | Pengesat e Serbisë për njohje të Kosovës; |

**TAB. 1.7** Dialogu në mbledhjet e Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike

| Nr | Data | Rend Dite/ Diskutim | Pika | Çështja e Diskutimit |
|---|---|---|---|---|
| 1 | 28 janar 2019 | Diskutim | | Përfundim: Projektligji të shqyrtohet në mbledhjen e radhës më 4 shkurt 2019 (e hënë); |
| 2 | 30 janar 2019 | Rend Dite | Shqyrtimi në parim i Projektligji nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë; | Përfundim: I rekomandohet Kuvendit që Projektligji të miratohet në parim; |
| 3 | 12 shkurt 2019 | Diskutim | | Propozim për formimin e një grupi punues për amendamentimin e Projektligjit për Dialogun, pasi që është miratuar në parim në seancë plenare; |
| 4 | 25 shkurt 2019 | Rend Dite | 1. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë;<br>2. Shqyrtimi Platformës për dialogun mbi Marrëveshjen përfundimtare, gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë; | Përfundim: Miratohet raporti me rekomandime për Projektligjin;<br>Përfundim: Platforma për dialogun, në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për votim, në komisioni nuk kishte vendimmarrje; |
| 5 | 6 mars 2019 | Rend Dite | 1. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë;<br>2. Shqyrtimi i Draft- Platformës për dialogun mbi Marrëveshjen përfundimtare, gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë; | Përfundim: Amendamentet 1 dhe 2 në Projektligj të propozuara nga deputeti Dukagjin Gorani përkrahen njëzëri nga anëtarët e pranishëm në mbledhjen e komisionit. Raporti me rekomandime iu përcollë komisioneve kryesore për shqyrtim nga kompetenca e tyre;<br>Përfundim: Miratohet, njëzëri nga anëtarët e pranishëm në mbledhjen e komisionit, Draft-platforma për dialogun dhe procedohet në procedurë të mëtejmë në Kuvend; |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 6 | 7 mars 2019 | Rend Dite | Shqyrtimi i raportit me rekomandime për Projektligjin nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë; | Përfundim:<br>Miratohet, njëzëri, nga anëtarët e pranishëm në mbledhjen e komisionit, raporti me rekomandime për Projektligjin dhe procedohet në procedurë të mëtejme në Kuvend; |
| 7 | 5 prill 2019 | Rend Dite | Raportim i ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, z.Endrit Shala; | Ndikimi i taksës 100% në investimet strategjike në Kosovë; |
| 8 | 2 maj 2019 | Rend Dite | Raportim i ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, z. Behgjet Pacolli; | Pengesat e Serbisë për njohje të Kosovës; |

**TAB. 1.8** Dialogu në mbledhjet e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

| Nr. | Data | Rend Dite/Diskutim | Çështja e Diskutimit |
|---|---|---|---|
| 1 | 13 maj 2019 | Diskutim | Shqyrtimi i kërkesës së KDI-së për vizitë të Komisionit në Ministri të Arsimit; |
| 2 | 25 qershor 2019 | Diskutim | Informimi i anëtarëve të Komsionit për Arsim dhe Administratë lidhur me vizitën e realizuar në Preshevë; |

**TAB. 1.9** Dialogu në mbledhjet e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

| Nr. | Data | Rend Dite/ Diskutim | Pika | Çështja e Diskutimit |
|---|---|---|---|---|
| 1 | 22 janar 2019 | Diskutim | | Lidhur me regjistrimin e operatorint të veriut për energji elektrike; |
| 2 | 12 shkurt 2019 | Diskutim | | Moszbatimi i marrëveshjes për energji nga Serbia; |
| 3 | 10 prill 2019 | Rend Dite | Dëgjim publik për Mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për energjinë elektrike | Rreth antarësimit të KOSTT në ENTSO dhe problemet që sjell mungesa e antarësimit; |
| 4 | 28 maj 2019 | Diskutim | | Mungesa e marrëveshje me Serbinë sa i përket hekurudhave; |
| 5 | 6 qershor 2019 | Rend Dite | Të ndryshme | Shyrtimi i propozimit të KDI-së për vizitë të Komisionit në ARKEP; |
| 6 | 11 qershor 2019 | Rend Dite | Të ndryshme | Komisioni vendosi që vizita mbikëqyrëse në ARKEP të realizohet të hënën më 17.6.2019; |
| 7 | 18 qershor 2019 | Diskutim | | Rreth zbatimit të marrëveshjeve me Serbinë; |
| 8 | 25 qershor 2019 | Rend Dite | Të ndryshme | Shqyrtimi i propozimit të KDI-së për vizitë të Komisionit në PTK; |
| 9 | 16 korrik 2019 | Rend Dite | Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2018 | Marrëveshja e telekomunikacionit; |

**TAB. 1.10** Dialogu në mbledhjet e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor

| Nr. | Data | Rend Dite/Diskutim | Çështja e Diskutimit |
|---|---|---|---|
| 1 | 23 janar 2019 | **Diskutim** | Lidhur me zbatimin taksës për ndalimin e importit të produkteve nga Serbia dhe Bosnja, sidomos atyre bujqësore; |
| 2 | 11 qershor 2019 | **Diskutim** | Pagesa e faturave të ujit në Veri; |

**TAB. 1.11** Dialogu në mbledhjet e Komisionit për të Drejtat Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione

| Nr. | Data | Rend Dite/Diskutim | Çështja e Diskutimit |
|---|---|---|---|
| 1 | 22 janar 2019 | **Diskutim** | Lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për persona të zhdukur; |
| 2 | 28 janar 2019 | **Diskutim** | Lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për persona të zhdukur; |
| 3 | 30 janar 2019 | **Diskutim** | Në këtë mbledhje është marrë vendim që të formohet grupi i punës për Ligjin për Persona të Zhdukur; |